



► PËR TË GJITHË TË INTERESUARIT QË DËSHIROJNË TË BËHËN PJESE E SAMITIT TË DITË TË DIASPORËS, PROCESI I REGJISTRIMIT "ON-LINE" ËSHËTË ENDE I HAPUR. REGJISTRIMI KRYHET NË FAGËN ELEKTRONIKË TË SAMITIT.



► SAMITI I DIASPORËS EDHE SI NJË MUNDËSI PËR TË VIZITUAR TIRANËN, DHE ME SHUMË ME "UDHËRRËFYESIN" E SAMITIT TË DITË TË DIASPORËS PËR PËSEMARRESIT E T.J.



► SAMITI I DIASPORËS DO TË SHOQËROHET EDHE ME NJË KALENDAR TË PASUR AKTIVITESH. PËRGLATË TËRE DITËVE PËSEMARRESIT DO TË KENË MUNDËSI TË NDJEJN NJË SËRË EVENTESH TË PËRGATITURA NË QYTETET E TIRANËS DHE LEZHËS.



AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS



FONDI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS



QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN

NEWSLETTER E DIASPORËS

#6

PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

Ministri në Itali, bisedime për krijimin e Dhomës së Tregtisë për Diasporën Shqiptare



Ministri i Shtetit për Diasporën, z.Pandeli Majko është duke zhvilluar një vizitë pune në Itali, ku u takua me përfaqësues të Konfederatës Kombëtare të Zefjarisë (KKZ).

Të dy palët diskutuan mbi koordinimin dhe bashkëpunimin në fushën e sipërmarrjes dhe tregtisë, si një mjet i rëndësishëm për të nxitur investimet dhe për të forcur marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Italisë. Gjithashtu gjatë këtij takimi u diskutuan detajet konkrete për krijimin e Dhomës së Tregtisë për Diasporën Shqiptare në Itali (DHTDSHI), e cila në bashkëpunim me Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës do të jetë një pikë mbështetëse për biznesin e vogël dhe të mesëm të krijuar nga shqiptarët e vendosur në Itali.

28

SHKURT

SAMITI I DITË TË DIASPORËS

- 14:00 Regjistrimi i pjesëmarrësve në Samit ▶ Pajtim | Emprimje
- 19:00 Mbrëmje në Tiranë - Ceremonia e mbylljes së pjesëmarrësve në Samit ▶ Pajtim | Emprimje
- 20:30 Mbrëmje e lirë

Zv.ministri i jashtëm përcaktohet koordinator shtetëror për marrëveshjet e sigurimeve të shqiptarëve në Diasporë

Kryeministri ka miratuar propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën për përcaktimin e koordinitorit që do të mbulojë procesin e negociimit të marrëdhënieve në fushën e sigurimeve të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë Shqipërisë, zv.ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme z. Etjën Xhafaj.

Detyra e koordinitorit shtetëror është ndjekja e procesit të inicimit, negociimit dhe finalizimit të marrëveshjeve shtetërore dypalëshe në fushën e sigurimeve shoqërore për shtetasit shqiptarë jashtë vendit. Informacionin më të plotë mund ta lexoni këtu: <https://diaspora.gov.al/zv-ministri-i-jashtem-percaktohet-koordinator-shteteror-per-marreshjet-e-sigurimeve-te-shqiptareve-ne-diaspore>

01

MARS

SAMITI I DITË TË DIASPORËS

- 09:00 Njiza drejt vendit ku do të mbahet Samiti ▶ Pajtim | Emprimje
- 09:30 Mbrëmja në Shqipëri e Diasporës ▶ Pajtim | Emprimje
- 10:00 Sezioni Kuvendues Plenar i Diasporës Shqiptare me Pjesëmarrjen e Autoriteteve Zyrtare ▶ Pajtim | Emprimje
- 11:15 Pushim kafeje ▶ Pajtim | Emprimje

Vizita në Itali, ministri takim me rrjetin e avokatëve shqiptar



Gjatë vizitës së tij në Itali ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko zhvilloi një takim me rrjetin e avokatëve shqiptarë në Itali. Në takimin e kryer në ambientet e një prej institucioneve enciklopedike me prestigjioze në botë, "Treccani" pati diskutime të shumta mbi situatën e shqiptarëve në Itali dhe rrjetëzimin e shqiptarëve në vendin fqinj.

Në fund të takimit, përfaqësuesit e rrjetit të avokatëve i dhuruan ministrit librin "Politikat Shtetërore për Diasporën" të përkthyer në italisht në mënyrë vullnetare nga anëtarët e rrjetit të avokatëve shqiptarë në Itali.

SAMITI I DITË TË DIASPORËS

- 11:30 **Pandeli Diskutimi Paralele** ▶ Pajtim | Emprimje
Vota si e Drejtë!
Politika e të Shtetërore për Diasporën
Diaspora dhe të Drejtat e saj në vendin fqinj
Zhvillimi Ekonomik i Qendrësishëm
Vendlindja dhe Diaspora
Ekonomia, Revolucion, Injenuitë
Identiteti Shqiptar
E ardhmja filloz nga Diaspora!
Artes, Kulturës, Art dhe Shqipëria
si shtet demokratik
Feset nga Shqipëria Juaj
Tërbënie, Agjencione
- 13:30 **Sezioni Përblyllës**
Konkluzionet e Diskutimeve dhe Dokumenti Përfundimtar i Samitit
Një hapësirë e shprehjes së IDH
- 15:00 Njiza drejt vendeve të drektës ▶ Pajtim | Emprimje
- 18:30 Mbrëmja në Mbrëmjen Gala ▶ Pajtim | Emprimje
- 19:00 Mbrëmja Gala e Samitit II të Diasporës Shqiptare ▶ Pajtim | Emprimje
Dokument i mbylljes "Diaspora e Shtet e Shqipëria"
Dokument i mbylljes "Shqipëria e Shtet e Shqipëria"
- 20:30 Darkë e lirë

Mbahet mbledhja e radhës për përgatitjen e programacionit të dedikuar për Diasporën në RTSH

Grupi ndër-institucional i punës për përgatitjen e platformës së programeve, të emisioneve, të posaçme, për mësimin e gjuhës shqipe, kulturën shqiptare dhe identitetin kombëtar të dedikuara për Diasporën, ka mbajtur mbledhjen e radhës ku u diskutua mbi propozimet e ministrit përkatës për realizimin e emisioneve të dedikuara televizive që do të kenë në fokus shqiptarët që jetojnë jashtë vendit.

Qëllimi kryesor i këtij grupi pune të përbërë nga ministri i Shtetit për Diasporën, ministri përgjegjës për arsimin, zëvendësministri përgjegjës për arsimin, zëvendësministri përgjegjës për kulturën si dhe zëvendësministri në ministrinë përgjegjës për punët e jashtme, është përgatitja e një platforme programesh të posaçme për mësimin e gjuhës shqipe, kulturën shqiptare dhe identitetin kombëtar të cilat do të transmetohen në RTSH Diaspora, me qëllim përhapjen e kulturës dhe traditës shqiptare në Diasporë.

02

MARS

SAMITI I DITË TË DIASPORËS

- 09:30 Njiza drejt Lezhës ▶ Pajtim | Emprimje
- 12:00 Ceremonia e 575-jetorit të Rrethit të Lezhës ▶ Pajtim | Emprimje
- 13:00 Darkë buffet në nder të pjesëmarrësve në Samit nga Kryetari i Bashkisë së Lezhës ▶ Pajtim | Emprimje
- 15:30 Njiza drejt Tiranës ▶ Pajtim | Emprimje
- 17:30 Mbrëmja në Tiranë ▶ Pajtim | Emprimje
- 18:00 Darkë e lirë

Miratohet vendimi për rregullat e administrimit e llogarive të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës



Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës si një nga strukturat kryesore të aplikimit të politikave të reja shtetërore për Diasporën shqiptare tashmë ka instrumentet financiare nëpërmjet të cilave do të operojë për të realizuar nxitjen e zhvillimit social-ekonomik të Diasporës.

Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin për miratimin e rregullave dhe të procedurave të hollësishme për administrimin e llogarive, krijimin dhe përdorimin e të ardhurave, të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, çka do të shërbejë për veprimtarinë e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës në hartimin, menaxhimin, financimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e projekteve të lidhura me misionin e tij. Për të mësuar më shumë mund të klikoni [këtu](#).

Informimi i Diasporës shqiptare, zgjidhet koordinatori kombëtar që do të mbikëqyrë procesin

Informimi i Diasporës shqiptare, zgjidhet koordinatori kombëtar që do të mbikëqyrë procesin Drejtori i Programimit dhe Zhvillimit, në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), z. Fatjon Hallkaj do të jetë koordinatori shtetëror për informimin e Diasporës shqiptare.

Qëllimi punës së koordinatorit shtetëror për informimin e Diasporës është zbatimi i masës 51, të planit të veprimit, të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendim nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave. Në funksion të kësaj mase ai do të vlerësojë dhe koordinojë punën për informacionin që publikohet nga institucionet e administratës shtetërore për interesat e komunitetit shqiptar jashtë vendit.

Miratohet koordinatori kombëtar për Programin vjetor të Aktiviteteve për Diasporën



Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të vendimit nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe të planit të veprimit", u miratua propozimi i ministrit të Shtetit për Diasporën për caktimin e zëvendësministrit të Turizmit dhe Mjedisit, znj. Ornela Çuçi, si koordinator shtetëror për ndjekjen dhe organizimin e programit vjetor të aktiviteteve shtetërore në interes të diasporës shqiptare dhe "Ditët e Shqipërisë"

Zv.ministria Çuçi do të jetë përgjegjëse për koordinimin dhe organizimin e aktiviteteve në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në Diasporë, mbi bazën e një programi vjetor si dhe aktivitete të tjera periodike për turizmin shqiptar. Informacioni i plotë në linku-n e mëposhtëm <https://diaspora.gov.al/miratohet-koordinatori-kombetar-per-programin-vjetor-te-aktiviteteve-per-diasporen>

Gjatë takimeve me koordinatorët e katër paneleve të diskutimeve, që do të mbahen në Samitin e Dytë të Diasporës



Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, priti në një takim Ambasadorin e Suedisë në Tiranë z. Johan Ndisi



Ministri bashkëbisedoi me Ambasadorin për misionin dhe zotimet e Ministrisë së Diasporës, si dhe për strukturën organizative dhe ligjore, si dhe foli për mundësitë e bashkëpunimit dhe projektet e mundshme të përbashkëta. Gjithashtu theksoi rolin e rëndësishëm që mund të ketë Diaspora shqiptare në Suedi në ndërtimin e urave në mes dy vendeve. Ndërsa Ambasadori suedez, z. Ndisi premtoi angazhimin e tij në kërkim të mundësive të bashkëpunimit mes dy vendeve.

